



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 44

Tiranë – E mërkurë, 25 mars 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 13/2015 datë 26.2.2015	Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë..... 1891
Ligj nr. 16/2015 datë 5.3.2015	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar..... 1899
Ligj nr. 18/2015 datë 5.3.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administratore e fondeve grant, të siguruar nga qeveri të vendeve të ndryshme, nën fondin e veçantë të aksionarëve të Berzh-it, për planin e qëndrueshëm të transportit në Shqipëri..... 1899
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 246, datë 19.3.2015	Për ngarkimin e Gardës së Republikës së Shqipërisë për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrjen me qira financiare të automjeteve në dispozicion të disa funksionarëve publikë dhe Kryeministrit..... 1907
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 18.3.2015	Për ngritjen e Komitetit Shtetëror, për bashkërendimin e punës, për organizimin e aktiviteteve në kuadër të nismës “Lutja e Paqes 2015”, në bashkëpunim me Komunitetin Sant’Egidio..... 1909
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 250, datë 18.3.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 850, datë 15.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin, në pronësi, disa bashkive, të pronave që janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror”, dhe për një shtesë në vendimin nr.60, datë 1.2.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror”..... 1910

Urdhër i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 57 datë 2.3.2015	Për delegim kompetence.....	1910
Urdhër i ministrit të Mbrojtjes nr.87, datë 16.1.2015	Për delegim kompetencash.....	1911
Urdhër i ministrit të Mbrojtjes nr. 461, datë 16.3.2015	Për delegim kompetence.....	1911
Urdhër i ministrit të Mbrojtjes nr. 462, datë 16.3.2015	Për delegim kompetencash për dhënien e ndihmave financiare për ushtarakët e Forcave të Armatosura.....	1911
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të vdekur të shtetasit Ilia Shkira.....	1912



LIGJ
Nr. 13/2015

**PËR POLICINË USHTARAKE NË
FORCAT E ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i misionit, statusit, organizimit, përgjegjësive dhe detyrave të Policisë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 2
Misioni**

Misioni i Policisë Ushtarake është ruajtja e rendit ushtarak, garantimi i zbatimit të ligjit nga veprimtaritë e kundërligjshme në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, mbrojtja e jetës së personelit, mbrojtja e pronës shtetërore në administrim dhe përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, angazhimi në luftën kundër terrorizmit dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse e humanitare.

**Neni 3
Juridiksioni**

Policia Ushtarake e ushtron juridiksionin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe kur dërgohet me mision, shërbim ose në mbështetje të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, jashtë vendit.

**Neni 4
Statusi**

Policia Ushtarake është strukturë e specializuar në përbërje të Forcave të Armatosura, në varësi të

Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 5
Parimet**

Parimet bazë, në bazë të të cilave udhëhiqet Policia Ushtarake në veprimtarinë e saj, janë:

- a) ligjshmëria;
- b) mosdiskriminimi;
- c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- ç) proporcionaliteti;
- d) pavarësia operacionale;
- dh) integriteti, merita dhe profesionalizmi;
- e) transparenca;
- ë) ruajtja e informacionit të klasifikuar;
- f) kontrolli dhe llogaridhënia.

**Neni 6
Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Punonjës i Policisë Ushtarake” është shtetasi shqiptar, ushtarak ose civil, që shërben në Policinë Ushtarake.
2. “Informacion” është çdo njohuri që mund të komunikohet apo të dokumentohet, pavarësisht nga forma, që është nën kontrollin e Policisë Ushtarake.
3. “Përdorimi i forcës” është veprimi i drejtpërdrejtë i punonjësit të Policisë Ushtarake nëpërmjet forcës fizike, pajisjeve apo mjeteve të tjera, të dhëna në përdorim, në bazë dhe për zbatim të ligjit.
4. “Shoqërimi” është dërgimi i personit në ambientet e Policisë Ushtarake, me ose pa vullnetin e tij, për shkaqe të parashikuara në këtë ligj.
5. “Veprimtari informative” është veprimtaria e punonjësit të Policisë Ushtarake, e kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi për kërkimin, gjetjen, grumbullimin, administrimin, verifikimin, analizimin e të dhënave dhe informacioneve për veprimtari të kundërligjshme në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
6. “Fondi operativ” është pjesa e buxhetit të Policisë Ushtarake që përdoret në funksion të veprimtarive operative.



Neni 7

Fusha e veprimit

Veprimtaria e Policisë Ushtarake ushtrohet mbi të gjitha subjektet ushtarake e civile, vendase dhe të huaja, me ose pa shtetësi, të cilat, me veprimet e tyre, cenojnë veprimtarinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë brenda e jashtë vendit dhe mbështetet në dispozitat e këtij ligji dhe në legjislacionin në fuqi.

**KREU II
ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E
POLICISË USHTARAKE**

Neni 8

Organizimi

Policia Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë është e organizuar në bazë reparti, nënreparti, sektori, inspektorati, shërbimi, seksioni dhe nënseksioni.

Neni 9

Rendi ushtarak

Në Policinë Ushtarake organizohet dhe funksionon seksioni i rendit ushtarak, i cili siguron dhe kontrollon zbatimin e akteve ligjore e nënligjore për rendin dhe disiplinën ushtarake në kuadrin e veprimtarisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 10

Policia Kriminale Ushtarake

1. Në Policinë Ushtarake organizohet dhe funksionon Policia Kriminale Ushtarake, si organ i specializuar për parandalimin, zbulimin, ndjekjen e veprimtarisë kriminale, kapjen e personave që kanë kryer ose përgatiten të kryejnë vepra penale ndaj Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Për sigurimin e informacionit të nevojshëm, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Policia Kriminale Ushtarake shfrytëzon burime njerëzore, dokumente, mjete teknike e elektronike, mbikëqyrje të fshehtë, si dhe krijon bazë të dhënash të veçantë për personat që kanë kryer apo janë të dyshuar për kryerjen e një vepre penale.

3. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Policia Kriminale, me atributet e Policisë Gjyqësore, kryen veprimtari procedurale në fazat e procedimit penal,

në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

4. Pozicionet e punës dhe gradat për punonjësën e Policisë Ushtarake që do të ketë atributet e Policisë Gjyqësore përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 11

Seksioni i Policisë Gjyqësore

1. Seksioni i Policisë Gjyqësore është seksioni përgjegjës, i cili ushtron detyrat e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

2. Policia Gjyqësore në Policinë Ushtarake kryen veprimtari procedurale përgjatë të gjitha fazave të procedimit penal, të urdhëruara apo të deleguara nga organi procedues ose me nismën e vet, në përputhje me legjislacionin procedural në fuqi.

3. Policia Gjyqësore në Policinë Ushtarake kryen të njëjtat funksione të parashikuara në ligjin për Policinë Gjyqësore.

Neni 12

Qarkullimi rrugor

Për organizimin, sigurimin dhe kontrollin e trafikut ushtarak, organizohet Struktura e Qarkullimit Rrugor, e cila e ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor.

Neni 13

Inspektorati për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin

Në strukturën e Policisë Ushtarake organizohet dhe funksionon Inspektorati për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin. Ky inspektorat e kryen veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

Neni 14

Shenjat dhe simbolet e Policisë Ushtarake

1. Punonjësi ushtarak mban shenjat dalluese dhe simbolet, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.



2. Për shkak të natyrës së punës, për realizimin e detyrës funksionale, punonjësi ushtarak përdor edhe veshje civile.

3. Punonjësi i Policisë Ushtarake pajiset dhe mban dokument specifik identifikimi, të cilin e paraqet gjatë kryerjes së detyrës.

Neni 15

Mjetet lëvizëse të Policisë Ushtarake

Në ushtrimin e detyrave, Policia Ushtarake përdor mjete lëvizëse. Ngjyra dhe shenjat dalluese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Burimet financiare

1. Policia Ushtarake ka buxhetin e vet, brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Buxheti i Policisë Ushtarake parashikon edhe fond operativ.

3. Përdorimi dhe kontrolli i fondit operativ rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

KREU III

PËRGJEGJËSITË E POLICISË USHTARAKE

Neni 17

Marrja e kallëzimit

Oficeri i Policisë Ushtarake, që gëzon atributet e Policisë Gjyqësore, merr kallëzim për veprat penale që cenojnë ose mund të cenojnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, vendos dokumentacionin përkatës në dispozicion të prokurorit që ka në kompetencë ushtrimin e ndjekjes penale.

Neni 18

Veprimtaria informative

1. Veprimtaria informative në Policinë Ushtarake realizohet nëpërmjet procesit të grumbullimit, sistemimit, vlerësimit, analizimit, shpërndarjes dhe përdorimit të informacionit për nevoja të parandalimit e zbulimit të autorëve të veprave penale ose për nevoja të mbrojtjes së rendit ushtarak.

2. Veprimtaria informative bazohet vetëm në të dhënat e marra në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Rregullat për realizimin dhe kontrollin e veprimtarisë informative, si dhe për ruajtjen e të dhënave miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 19

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale

1. Policia Ushtarake mbledh dhe përpunon vetëm të dhënat personale që janë të nevojshme për ndalimin e një rreziku real ndaj rendit ushtarak, si dhe për parandalimin, zbulimin, ndjekjen e hetimin e veprave penale të kryera në Forcat e Armatosura, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

2. Të dhënat personale dhe sensitive, të mbledhura për qëllime të këtij ligji, ruhen në dosje të veçanta dhe përdoren vetëm për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Të dhënat personale dhe sensitive, të ruajtura për qëllime të këtij ligji, evidentohen me një shenjë që tregon besueshmërinë dhe saktësinë e tyre. Për këtë qëllim, miratohet dhe zbatohet një sistem kodimi, i përcaktuar me udhëzim të Ministrisë të Mbrojtjes.

4. Çdo person, civil ose ushtarak, ka të drejtë të ankohet në rast se vlerëson se Policia Ushtarake ka shkelur të drejtat e tij për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sensitive, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Përpunimi i të dhënave kryhet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.

6. Rregullat për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Mbrojtjes.

Neni 20

Bashkëpunimi me individët

1. Policia Kriminale Ushtarake, për të siguruar informacionin, bashkëpunon edhe me individë brenda dhe jashtë Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



2. Punonjësi i Policisë Kriminale Ushtarake dhe personi që vendos marrëdhënie të fshehta bashkëpunimi detyrohen të ruajnë sekretin e bashkëpunimit, të informacioneve, të fshehtësisë së identitetit dhe të rrethanave të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Procedurat e bashkëpunimit me individë miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 21

Njoftimi për paraqitje në Policinë Ushtarake

1. Ushtaraku ose civili që punon në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë njoftohet nëpërmjet titullarit të strukturës ushtarake për t'u paraqitur në zyrat e Policisë Kriminale Ushtarake në këto raste:

- a) për të marrë informacion në lidhje me parandalimin e veprimit ose për raste të mosveprimit, që përbën veprë penale;
- b) për të identifikuar personin që mund të ketë dijeni për rrezikun apo veprën penale;
- c) për të identifikuar shkelësin e mundshëm të ligjit.

2. Njoftimi për paraqitje bëhet me anë të fletënjoftimit, duke përcaktuar arsyen e paraqitjes, punonjësin e Policisë Ushtarake, kohën, vendin dhe informacionin për të kontaktuar punonjësin e Policisë Ushtarake në rast pamundësie për t'u paraqitur.

3. Kur, për shkak të kushteve personale dhe familjare, personi që njoftohet nuk mund të paraqitet në zyrat e Policisë Ushtarake, punonjësi i Policisë Ushtarake mund ta marrë këtë informacion në vendbanimin e personit të njoftuar.

Neni 22

Hyrja në mjedise

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake ka të drejtë të hyjë në mjediset e reparteve e të institucioneve ushtarake vetëm:

- a) kur ka të dhëna të bazuara se është duke u kryer një krim;
- b) për kapjen e autorëve të një krimi, të cilët janë fshehur në këto mjedise;
- c) për të dhënë ndihmën e nevojshme në raste aksidentesh, zjarresh e fatkeqësish natyrore.

2. Punonjësi i Policisë Ushtarake ka të drejtë të hyjë në objektet e mbyllura dhe në zyrat e komandave me kërkesë të këtyre të fundit ose në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 23

Kontrolli i mjediseve

1. Kontrolli në mjediset, ku ushtrojnë veprimtarinë Forcat e Armatosura ose që lidhen me veprimtarinë e tyre, kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

2. Në rast flagrante ose në rast ndjekjeje të personit që është duke ikur, kur nuk lejohet nxjerrja e një vendimi kontrolli, oficerët e Policisë Gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

3. Punonjësit e Policisë Ushtarake bllokojnë pjesë të rrugëve, zyra e mjedise, ku ka ndodhur vepra penale, për ruajtjen e vendit të ngjarjes dhe të provave materiale deri në ardhjen e Policisë Gjyqësore ose të prokurorit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 24

Kontrolli i identitetit

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake i kërkon ushtarakut ose civilit që të paraqesë dokumentin e identifikimit, në rastet kur:

- a) është i pranishëm ose në afërsi të drejtpërdrejtë me vendngjarjen apo kur është dëshmitar i mundshëm i veprës penale;
- b) ekzekutohet një urdhër i organeve përkatëse;
- c) kërkohen personat e dyshuar për cenim të rendit ushtarak;
- ç) për rrethana të kohës dhe vendit dyshohet se ushtaraku ose civili është përfshirë në veprime të jashtëligjshme;
- d) vepron në kundërshtim me rregulloret ushtarake.

2. Për një identifikim të besueshëm të personit, punonjësi i Policisë Ushtarake bazohet në dokumentin specifik të identifikimit, të miratuar, përkatësisht, nga Ministri i Mbrojtjes, komandat e forcave ose reparteve e të ndërmarrjeve ushtarake, ose në dokumentin ligjor të identifikimit.



Neni 25

Kontrolli i personit

1. Kontrolli i ushtarakut ose civilit për kryerjen e një vepre penale në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë ushtrohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

2. Policia Ushtarake bën kontrolle, sekuestron prova materiale dhe ndalon personin në kushtet e flagrancës së kryerjes së një vepre penale, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

3. Kontrollat kryhen nga punonjës policie të së njëjtës gjini me personin e kontrolluar.

Neni 26

Mjediset e punës

Punonjësve të Policisë Ushtarake u krijohen kushte dhe mjedise pune të përshtatshme për kryerjen e detyrës së tyre funksionale brenda njësisë e reparteve nga komandat e forcave dhe drejtuesit e strukturave ushtarake.

Neni 27

Shoqërimi në Policinë Ushtarake

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake shoqëron në zyrat e Policisë Ushtarake në qendrat e reparteve apo të institucionit ushtarak ushtarakët:

a) që refuzojnë të paraqesin dokumentin e identifikimit;

b) për të cilët dyshohet për vërtetësinë e dokumentit të tij të identifikimit;

c) që kundërshtojnë ose pengojnë punonjësën e Policisë Ushtarake në kryerjen e detyrës;

ç) që janë gjendur në vendngjarje dhe për të cilët dyshohet se janë autorë të veprës penale;

d) që kërkohen nga organet e drejtësisë.

2. Punonjësi i Policisë Ushtarake shoqëron në zyrat e Policisë Ushtarake në qendrat e reparteve apo të institucionit ushtarak civilët që, brenda mjediseve ushtarake:

a) refuzojnë të paraqesin dokumentin e identifikimit;

b) për të cilët dyshohet për vërtetësinë e dokumentit të tij të identifikimit;

c) kundërshtojnë ose pengojnë punonjësën e Policisë Ushtarake në kryerjen e detyrës;

ç) janë gjendur në vendngjarje dhe për të cilët dyshohet se janë autorë të veprës penale.

3. Personit, që shoqërohet nga Policia Ushtarake, i krijohen kushte normale qëndrimi dhe, pas sqarimit të rrethanave të çështjes për të cilën është shoqëruar, kur nuk është i implikuar, lihet i lirë. Në të gjitha rastet, personi i shoqëruar nuk mund të mbahet më shumë se 10 orë.

Neni 28

Arrestimi dhe ndalimi

Punonjësi i Policisë Ushtarake bën arrestimin dhe ndalimin e ushtarakut ose civilit sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 29

Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit

1. Për të regjistruar të dhënat e personit të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, punonjësi i Policisë Ushtarake kryen këto veprime:

a) Në rast shoqërimit, punonjësi i Policisë Ushtarake evidenton për çdo person të shoqëruar të dhënat për:

i) gjenealitetet;

ii) vendbanimin;

iii) përkrahimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;

iv) gradën dhe detyrën që kryen;

v) arsyet e shoqërimit;

vi) orën, datën dhe vendin e shoqërimit;

vii) punonjësën e Policisë Ushtarake, i cili ka kryer shoqërimin.

b) Në rast arrestimi apo ndalimi, punonjësi i Policisë Ushtarake evidenton për çdo person të arrestuar apo të ndaluar të dhënat për:

i) gjenealitetet;

ii) vendbanimin;

iii) përkrahimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;

iv) gradën dhe detyrën që kryen;

v) veprën penale, për të cilën është arrestuar apo ndaluar;

vi) hollësi për mënyrën e kryerjes së veprës penale, për të cilën është arrestuar apo ndaluar;

vii) orën, datën dhe vendin e arrestimit apo të ndalimit;



viii) punonjësin e Policisë Ushtarake, i cili ka kryer arrestimin apo ndalimin.

c) Për çdo person të arrestuar apo të ndaluar, në çdo rast, punonjësi i Policisë Ushtarake merr të dhënat e mëposhtme:

i) shenjat e gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve të duarve;

ii) dy fotografi, një pamje ballore dhe një profil.

2. Të dhënat e parashikuara në nënndarjen “ii”, përkatësisht, të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, evidentohen në sistemin TIMS nga punonjësi i Policisë Ushtarake.

Neni 30

Përdorimi forcës

Punonjësi i Policisë Ushtarake përdor forcën, mjetet dhe pajisjet e tjera speciale, të dhëna në përdorim, në bazë dhe për zbatim të ligjit, kur kundërshtohet ose pengohet gjatë kryerjes së detyrës:

a) ndaj personit që përpiket të lirojë personin e shoqëruar;

b) nëse i ndaluar, i arrestuari ose personi që shoqërohet bën përpjekje të largohet forcërisht;

c) për të vendosur rendin ushtarak, të cenuar nga veprime të pakontrolluara të personelit të Forcave të Armatosura.

Neni 31

Mënyra e përdorimit të forcës

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake përdor forcën për të përmbushur një qëllim të ligjshëm vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura. Punonjësi i Policisë Ushtarake përdor nivelin minimal të forcës së nevojshme, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2. Punonjësi i Policisë Ushtarake përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara ku, ndër të tjera, përfshihen bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, mjetet goditëse, mjetet me goditje elektrike dhe armët e zjarrit.

3. Të dëmtuarit i jepet ndihmë, ku përfshihet edhe ajo mjekësore, pas përdorimit të forcës, në rast se kjo është e nevojshme dhe e mundur.

4. Punonjësi i Policisë Ushtarake duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj. Ky paralajmërim mund të mos

kryhet nëse rrethanat nuk e lejojnë, veçanërisht kur përdorimi i menjëhershëm i forcës është i nevojshëm për të parandaluar një rrezik real dhe të çastit.

Neni 32

Përdorimi i armëve të zjarrit

Punonjësi i Policisë Ushtarake përdor armët e zjarrit që ka në përdorim në rastet dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.

KREU IV

DETYRAT E POLICISË USHTARAKE

Neni 33

Detyrat

Policia Ushtarake, në përmbushje të misionit të saj, ka këto detyra:

a) mbron jetën, shëndetin dhe dinjitetin e ushtarakut nga çdo veprim i paligjshëm, kur ato cenohen për shkak të detyrës;

b) merr masa për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore për rendin dhe disiplinën ushtarake jashtë strukturave ushtarake në mjediset publike dhe jopublike;

c) me kërkesë të komandave dhe të drejtuesve të institucioneve ushtarake, ndërhyjnë në repartet ushtarake për parandalimin dhe mënjanimin e veprimeve të kundërligjshme që kanë të bëjnë me prishjen e rendit ushtarak;

ç) siguron rendin ushtarak në kuadër të veprimtarive të organizuara në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

d) merr masa për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprimtarisë kriminale ndaj pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, pronës e objekteve ushtarake;

dh) bën hetimin e veprave penale të kryera në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

e) merr masa për zbatimin e vendimeve të gjykatës dhe të akteve të Prokurorisë për personelin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

ë) ndërhyjnë për të ndërprerë aktet e terrorizmit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

f) mbron pronën shtetërore në administrim dhe përdorim të Forcave të Armatosura të Republikës



së Shqipërisë nga veprimtari të kundërligjshme;

g)ndërhyn përkrah Policisë së Shtetit për të rivendosur rendin në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, të krijuar si rezultat i kryerjes së veprave me qëllime terroriste dhe krimeve kundër autoritetit të shtetit;

gj)realizon, me urdhër të autoritetit epror, lirimimin e pronave në administrim ose përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes, të zëna forcërisht;

h)kryen detyra policore në interes të ushtarakëve shqiptarë që kryejnë misione jashtë vendit, si dhe forcave ushtarake të huaja, që veprojnë në territorin shqiptar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

i) kryen funksionet e Policisë Ushtarake në operacionet ushtarake dhe paqeruajtëse jashtë vendit, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara;

j) kontrollon e siguron transportin, lëvizjen dhe shfrytëzimin e mjeteve dhe të teknikës ushtarake;

k) shoqëron e siguron personalitetet e larta ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, delegacionet e huaja ushtarake të njësuara me to, si dhe forcat e huaja ushtarake që kalojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

l) mban nën kontroll rrjetin rrugor në zonat e operacioneve;

ll) jep masa administrative, sipas Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, për drejtuesit e mjeteve ushtarake që shkelin rregullat e qarkullimit rrugor në poligonet e stërvitjes dhe jashtë ambienteve ushtarake;

m) kryen ekspertizën autoteknike, në rastet e aksidenteve dhe incidenteve rrugore në teknikë ushtarake;

n) kontrollon e merr masa për zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri;

nj) mbështet kryerjen e operacioneve ku angazhohen Forcat e Armatosura, brenda dhe jashtë vendit;

o) Policia Ushtarake, në gjendje lufte, bën sigurimin e personelit, të materialeve dhe mjeteve luftarake, merr masa për grumbullimin, evakuimin, ruajtjen dhe sigurimin e robërve të luftës, si dhe të personelit civil të ndaluar.

Neni 34

Bashkëveprimi me strukturat e tjera

1. Në përmbushje të misionit dhe realizimit të detyrave, Policia Ushtarake bashkëvepron me strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, strukturat e inteligjencës ushtarake, Policinë e Shtetit, Shërbimin Informativ të Shtetit, prokurorinë, gjykatat, policitë e tjera të përcaktuara me ligj dhe me njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, të përcaktuara me akte normative të përbashkëta.

2. Policia Ushtarake bashkëvepron me policitë ushtarake të vendeve aleate në operacionet brenda dhe jashtë vendit, në bazë të marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe.

Neni 35

Shkëmbimi i informacionit

1. Policia Ushtarake shkëmben informacione me strukturat e tjera shtetërore, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 34, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet Policisë Ushtarake dhe strukturave ose organeve të tjera rregullohet me akte normative të përbashkëta të titullarëve të institucioneve përkatëse.

Neni 36

Detyrimi për të mos dhënë informacion

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake nuk duhet të japë informacion, për të cilin ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës ose jashtë saj, përveç personave të autorizuar me ligj.

2. Detyrimi për të mos dhënë informacion zbatohet edhe për punonjësin e Policisë Ushtarake të liruar ose të larguar nga Policia Ushtarake.

3. Për informacione, që kanë të bëjnë me identitetin e dëshmitarëve dhe informatorëve, Policia Ushtarake zbaton legjislacionin në fuqi.

KREU V

PRANIMI, EMËRIMI, KUALIFIKIMI, SHËRBIMI DHE TRAJTIMI I PUNONJËSIT TË POLICISË USHTARAKE

Neni 37

Pranimi, emërimi dhe karriera

1. Pranimi, emërimi dhe karriera e punonjësit ushtarak kryhen sipas kritereve të përcaktuara në



legjislacionin në fuqi për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Pranimi, emërimi dhe karriera e punonjësit civil kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për punonjësit civilë në Forcat e Armatosura.

Neni 38

Trajnimi profesional i punonjësit të shërbimeve të Policisë Ushtarake

1. Punonjësi i shërbimeve të Policisë Ushtarake i nënshtrohet trajnimit profesional nga institucionet arsimore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ose jashtë tyre, të cilat ofrojnë trajnim në përputhje me ligjin.

2. Programet, kohëzgjatja dhe vendi i kryerjes së trajnimeve profesionale jashtë institucioneve arsimore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë përcaktohen me akt normativ të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe titullarit të institucionit që kryen trajnimin.

Neni 39

Etika dhe përgjegjësia disiplinore e punonjësit të Policisë Ushtarake

1. Gjatë përmbushjes së detyrave të caktuara me ligj, punonjësi i Policisë Ushtarake zbaton Kodin e Etikës së Policisë.

2. Procedimi disiplinor dhe masat disiplinore ndaj punonjësit të Policisë Ushtarake rregullohen nga legjislacioni në fuqi për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Procedimi disiplinor dhe masat disiplinore ndaj punonjësit të shërbimeve të Policisë Ushtarake rregullohen nga legjislacioni në fuqi për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Neni 40

Sigurimi i jetës

Punonjësi i Policisë Ushtarake përfiton sigurim jete. Kategoritë e përfituesve, masat dhe kriteret përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 41

Trajtimi i veçantë

1. Kur punonjësi i Policisë Ushtarake vdes ose bëhet i paaftë për punë gjatë kryerjes së detyrës ose

për shkak të detyrës, familja e tij ose ai vetë përfitojnë pension në masën e pagës së plotë që ka pasur në çastin që i ka lindur e drejta për këtë përfitim.

2. Kur punonjësi i Policisë Ushtarake, gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj, i dëmtohet prona, ai ka të drejtën e kompensimit. Masa dhe kriteret për kompensim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Punonjësi i Policisë Ushtarake trajtohet me veshmbathje civile, në vlerë leku, një herë në vit, në masën e gjysmës së pagës mujore, sipas vendit të punës. Kriteret e përfitimit të veshmbathjeve civile përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Punonjësi i Policisë Ushtarake përfiton shtesë mbi pagë për kushte të veçanta pune dhe shërbimi. Masa e këtyre shtesave rregullohet sipas legjislacionit në fuqi.

5. Punonjësi i Policisë Ushtarake, përveç të drejtave të përcaktuara në këtë ligj, gëzon dhe të gjitha të drejtat e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 42

Mbrojtja e veçantë

Policia Ushtarake siguron mbrojtje të veçantë për punonjësin e Policisë Ushtarake, të cilit i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës. Kushtet dhe mënyra e mbrojtjes së veçantë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 43

Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohet për nxjerrjen e akteve nënligjore brenda 6 muajve:

a) Këshilli i Ministrave, në zbatim të neneve 14, pika 1; 15; 16, pika 3; 40; 41, pikat 2 dhe 3; dhe 42 të këtij ligji;

b) Ministri i Mbrojtjes, në zbatim të nenit 19, pikat 3 dhe 6, të këtij ligji;

c) Ministri i Mbrojtjes, në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm, në zbatim të neneve 10, pika 4; 18, pika 3; dhe 20, pika 3, të këtij ligji.



Neni 44
Shfuqizimi i akteve

Ligji nr. 9069, datë 15.5.2003, “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që vjen në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 45
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 26.2.2015

LIGJ
Nr. 16/2015

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9584, DATË 17.7.2006, “PËR PAGAT, SHPËRBLIMET DHE STRUKTURAT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA KUSHTETUESE DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA TË PAVARURA, TË KRIJUARA ME LIGJ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 2, pika 1, emërtimi “Komisioni i Shërbimit Civil” zëvendësohet me emërtimin “Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”.

Neni 2

Në lidhjen nr. 1 të nenit 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në klasifikimin “D”, emërtimi “Kryetari i Komisionit të Shërbimit Civil” zëvendësohet me emërtimin “Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”.

2. Në klasifikimin “E”, emërtimi “Anëtari i Komisionit të Shërbimit Civil” shfuqizohet.

Neni 3
Dispozitë kalimtare

Për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ky ligj i shtrin efektet financiare nga data e zgjedhjes së tij nga Kuvendi.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 5.3.2015

Shpallur me dekretin nr. 8999, datë 19.3.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 18/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA QEVERI TË VENDEVE TË NDRYSHME, NËN FONDIN E VEÇANTË TË AKSIONARËVE TË BERZH-IT, PËR PLANIN E QËNDRUESHËM TË TRANSPORTIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë,



të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administratore e fondeve grant, të siguruar nga qeveri të vendeve të ndryshme, nën fondin e veçantë të aksionarëve të BERZH-it, për planin e qëndrueshëm të transportit në Shqipëri.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miruar në datën 5.3.2015

Shpallur me dekretin nr. 9001, datë 19.3.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE E GRANTIT NR.C
28906/EBSF-2011-12-179

MARRËVESHJE

PËR PLANIN E QËNDRUESHËM TË
TRANSPORTIT NË SHQIPËRI NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCEVE DHE BANKËS EUROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM SI
ADMINISTRATOR I FONDEVE GRANT TË
SIGURUARA NGA QEVERI TË NDRYSHME
NËN FONDIN E VEÇANTË TË
AKSIONARËVE TË BERZH

Marrëveshja e Grantit nr. C28906/EBSF-2011-12-179, më datë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Marrësi) dhe Bankës Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka” ose “BERZH”) me Zyrat Qendrore në *One Exchange Square*, London EC2A 2JN, United Kingdom, një institucion financiar i krijuar në përputhje me Marrëveshjen për Themelimin e Bankës, firmosur në Paris më 29 maj 1990, e cila vepron si administrator i fondeve grant, të cilat mbahen në Fondin e Veçantë të Aksionarëve, të ofruara nga qeveri të shteteve të ndryshme (Donatori).

HYRJE

Duke pasur parasysh se Bankës i është kërkuar të ofrojë bashkëpunim teknik për Marrësin në formën

e shërbimeve të konsulencës financiare për përgatitjen e një plani mbështetës për transportin (Projekti), për të ndihmuar Marrësin në përmbushjen e objektivave sfiduese në uljen e konsumit të energjisë në sektorin e transportit në Shqipëri (Shërbimet);

duke pasur parasysh se Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI) do të sigurojë një konsulent (Konsulenti) në përputhje me politikat dhe rregullat për prokurim dhe me procedurat e tjera të BERZH-it;

duke pasur parasysh se MTI do të lidhë një Kontratë Konsulente për parashikimin e shërbimeve të konsulentit (Kontrata e Konsulencës) për shumën tavan deri në 289,383.00 euro;

duke pasur parasysh se sipas Marrëveshjes së Fondit për Bashkëpunim Teknik, midis Donatorit dhe Bankës, Donatori ka rënë dakord dhe ka miratuar vënien në dispozicion të fondeve deri në vlerën 289,383.00 euro në formën grant (Granti) për të financuar Shërbimet e Konsulentit sipas kushteve të mëposhtme;

duke pasur parasysh se Marrësi do të ndërmarrë çdo masë të nevojshme në përputhje me ligjin shqiptar për ta bërë Grantin të disponueshëm për MTI, me anë të një marrëveshje për transfertë, për qëllimin e specifikuar në kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje;

duke pasur parasysh se Marrësi duhet të përcaktojë si kusht për marrjen e Grantit se, për të përfituar Shërbimet, MTI duhet të pajtohet me të gjitha detyrimet kontraktuale të përcaktuara në këtë Marrëveshje për Grant për MTI;

duke pasur parasysh se Banka ka rënë dakord të administrojë Grantin sipas kushteve të përcaktuara më poshtë;

për këtë arsye, palët bien dakord me kushtet në vijim:

Neni 1

Përkufizimet

1.01 Përkufizimet dhe interpretimi

Termet e mëposhtëm me shkronjë të madhe do të kenë kuptimet e përcaktuara më poshtë, në cilëndo pjesë të kësaj Kontrate, me përjashtim të rastit kur konteksti kërkon një tjetër kuptim:

a) “Kostot e detyrës” do të thotë kostoja e shërbimeve.



b) “Banka ose BERZH” do të thotë Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

c) “Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës”, ose “MTI” do të thotë Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, palë së cilës do t’i ofrohen shërbimet sipas Kontratës së Konsulencës.

d) “Angazhimi i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës” do të thotë kontributi financiar i ofruar nga MTI për koston e shërbimeve.

e) “Konsulent”: do të thotë pala e cila do të realizojë shërbimet.

f) “Kontrata e Konsulencës” do të thotë marrëveshja që do të vendoset midis MTI-së dhe Konsulentit për realizimin e Shërbimeve.

g) “Vendi i detyrës” është Shqipëria.

h) “Donatori” do të thotë ofruesi i fondeve të Grantit, siç edhe specifikohet në hyrjen e kësaj Marrëveshjeje.

i) “Grant” do të thotë shuma e fondeve të vëna në dispozicion nga Dhuruesi për Bankën, si administrator, për qëllimet e financimit të Kontratës së Konsulencës.

j) “Marrëveshja e Grantit” do të thotë kjo marrëveshje dhe të gjitha shtojcat bashkëngjitur, duke pasur parasysh se ajo mund të redaktohet herë pas here.

k) “Shuma Maksimale e Kontratës” do të thotë shuma deri në 289,383.00 euro, e cila duhet t’i paguhet Konsulentit sipas një Kontrate Konsulente, duke përfshirë të gjitha tarifatat, kuotat dhe shpenzimet.

l) “Drejtuesi i Operacionit” do të thotë anëtari i stafit të Bankës i cili është përgjegjës për monitorimin e implementimit të Kontratës së Konsulencës në emër të Bankës.

m) “Marrësi” do të thotë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

n) “Shërbimet” do të thotë shërbimet e realizuara nga Konsulenti për MTI-në siç përcaktohet në Kontratën e Konsulencës.

1.02 Interpretimi

a) Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e saj.

b) Në këtë Marrëveshje, referencë në një Akt është për atë Akt dhe për rregullat e përcaktuara sipas atij Akti, duke qenë se ai Akt dhe rregullat mund të amendohen ose të modifikohen në çdo

kohë, si edhe ndaj çdo akti ose rregulli që mund të miratohet dhe që ka efekt plotësues ose zëvendësues për atë akt apo rregull.

c) Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj çdo gjinie përfshin referencën ndaj të gjitha gjinive të tjera, numri njëjës përfshin shumësin dhe e anasjella, dhe referencat ndaj personave përfshijnë korporatat, shoqëritë jo të inkuorporuara dhe partneritetet. Referenca ndaj një personi përfshin pasuesit dhe personat të cilëve u janë kaluar të drejtat.

Neni 2

Granti

2.01 Granti

a) Banka bie dakord të vendos në dispozicion të Marrësit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, Grantin në shumën e cila nuk e kalon vlerën prej 289,383.00 euro, apo ekuivalentin e saj.

b) Granti do të aplikohet vetëm për të financuar Shërbimet gjatë periudhës së angazhimit të Konsulentit.

2.02 Pagesa

a) Marrësi dhe Banka bien dakord që Banka është e autorizuar ta paguajë Konsulentin direkt në emër të MTI-së.

b) Shuma e Grantit do t’i paguhet Konsulentit direkt nga Banka në emër të dhe sipas udhëzimeve të MTI në përputhje me dispozitat në Kontratën e Konsulencës.

c) Sapo të merret fatura dhe dokumentet mbështetëse të dërguara nga Konsulenti në përputhje me parashikimet e Kontratës së Konsulencës, MTI do të kontrollojë dhe verifikojë sa më shpejt të jetë e nevojshme faturën dhe përmbushjen e kënaqshme të atyre Shërbimeve të Konsulentit me të cilat lidhet fatura.

d) Nëse Shërbimet rezultojnë të jenë të kënaqshme dhe MTI është e kënaqur me faktin se shumatat e tarifuarat në faturë korrespondojnë me shumatat e përcaktuara në Kontratën e Konsulencës, atëherë fatura, e cila është në mbështetje të dokumenteve dhe një deklaratë (siç përcaktohet në shtojcën A të Marrëveshjes së Grantit), e cila certifikon miratimin e Shërbimeve, duhet t’i dërgohet Bankës për të bërë pagesën në Bank’s Tirana Resident Office, ndërtesa “Torre Drin”, kati i 4-t, rruga “Abdi Toptani”, Tiranë, Shqipëri.



2.03 Taksat dhe detyrat

a) MTT bie dakord që fondet e Grantit të mos përdoren për të paguar taksat indirekte (duke përfshirë TVSH-në) të lidhura me Shërbimet apo me këtë Marrëveshje Granti të përcaktuar sipas ligjeve dhe rregullave, të cilat janë në fuqi në Vendin e Detyrës.

b) MTT do ta këshillojë Bankën nëse ndonjë taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) është e tarifueshme në përputhje me Kontratën e Konsulencës.

c) MTT bie dakord se çdo taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) e pagueshme do t'i paguhet Konsulentit nga MTT.

d) Nëse ndonjë taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) është e tarifueshme, në momentin kur Bankës i dërgohet vërtetimi sipas klauzolës 2.02 (d), edhe MTT duhet të vërtetojë pagesën e vet të bërë për taksat indirekte (duke përfshirë TVSH-në) të pagueshme në cilëndo faturë të mëparshme të Konsulentit, dhe gjithashtu të marrë përsipër të paguajë taksën indirekte (duke përfshirë TVSH) në faturën aktuale.

e) Nëse MTT nuk paguan ndonjë nga taksat indirekte (duke përfshirë TVSH), kjo Marrëveshje mund të ndërpritet sipas klauzolës 5.03.

Neni 3

Zbatimi i Projektit

3.01 Bashkëpunimi dhe informacioni

a) Banka dhe MTT duhet të bashkëpunojnë plotësisht për sa i përket administrimit të Kontratës së Konsulencës.

Herë pas here, bazuar në kërkesën e ndonjërës prej tyre, Banka, Marrësi dhe MTT do të shkëmbejnë mendimet në lidhje me progresin e Projektit, Shërbimeve, qëllimeve për të cilat jepet ky Grant, përmbushjen e detyrimeve që ka MTT në përputhje me këtë Marrëveshje, dhe përmbushjen e detyrimeve që ka MTT dhe Konsulenti bazuar në Kontratën e Konsulencës, si dhe t'i sigurojë palës tjetër të gjitha informacionet e nevojshme bazuar në kërkesën e kësaj pale.

b) MTT duhet të informojë menjëherë Bankën për çdo ndryshim të propozuar për natyrën dhe qëllimin e Projektit, apo të Shërbimeve apo biznesit ose operacioneve të MTT-së dhe të çdo zhvillimi apo kushti, i cili mund të ndikojë materialisht

mbarëvajtjen e Projektit, apo të shërbimeve, apo të biznesit ose të operacioneve të MTT-së.

c) Pa cenuar tërësinë e sa më sipër, MTT nuk duhet të bëjë ndryshime materiale, duke përfshirë këtu edhe ndonjë vendim që lidhet me detyrën dhe nënkontraktimin në Kontratën e Konsulencës, pa marrë fillimisht pëlqimin me shkrim të Bankës, pëlqim i cili nuk mund të kundërshtohet pa pasur arsye. Në çfarëdo rasti, Banka duhet të njoftohet nga MTT për të gjitha ndryshimet në Kontratën e Konsulencës.

3.02 Relacione dhe Raporte

a) MTT duhet:

i) të kujdeset për mbarëvajtjen e procedurave dhe të relacioneve, të përshtatshme për regjistrimin dhe monitorimin e progresit të Shërbimeve (duke përfshirë kostot dhe përfitimet, të cilat burojnë prej tyre), si edhe të identifikojë Shërbimet e financuara nga Granti, dhe t'i ketë të disponueshme këto relacione për përfaqësuesit e Bankës sipas kërkesës së vet Bankës;

ii) të kujdeset për mbarëvajtjen e llogarive dhe vërtetimeve financiare (bilancet, vërtetimet e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe vërtetime të tjera të lidhura me to), të cilat janë të nevojshme për të monitoruar dhe regjistruar progresin e Shërbimeve, duke përfshirë kostot dhe përfitimet të cilat burojnë nga këto Shërbime, si edhe të pajisë Bankën sipas kërkesave të saj me kopje të këtyre informacioneve, me të gjitha detajet sipas kërkesës së Bankës;

iii) t'u bëjë të mundur përfaqësuesve të Bankës, sipas kërkesës së Bankës, të kontrollojnë çdo mjet të përfshirë, apo të përmendur në Projekt apo në Kontratën e Konsulencës, si edhe të kontrollojnë Shërbimet e financuara nga Granti, si edhe çdo impiant, instalim, vend, punim, ndërtesë, pronë, pajisje, relacion dhe dokument të lidhur me përmbushjen e detyrimeve të MTT apo të Konsulentit në përputhje me këtë Marrëveshje apo Kontratë Konsulencë;

iv) të pajisë përfaqësuesit e Bankës me informacione të tilla, sipas kërkesës së Bankës, në lidhje me Projektin dhe Shërbimet, koston e tyre, dhe kur të jetë e përshtatshme, me përfitimet që priten të burojnë prej tyre, si edhe me shpenzimin e të ardhurave të Grantit.

v) të pajisë ose të mundësojë pajisjen e përfaqësuesve të Bankës me planet, specifikat,



raportet, kontratat, dokumentet (duke përfshirë rezultatet në përputhje me Kontratën e Konsulencës), si edhe modifikimte apo shtesat në çdo material, sipas kërkesave të Bankës.

b) Menjëherë pas përmbushjes së Shërbimeve, MTI duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë Bankës një raport me një gjuhë të detajuar, me shtrirje dhe me detaje të tilla që përputhen me kërkesat e arsyeshme të Bankës, në lidhje me zbatimin dhe mbarëvajtjen e Shërbimeve, me koston dhe me përfitimet e marra prej tyre, si edhe në lidhje me përmbushjen e detyrimeve respektive nga ana e MTI, Konsulentit dhe të Bankës, në përputhje me Marrëveshjen e Grantit dhe Kontratën e Konsulencës, sipas rastit.

c) Të gjitha raportet dhe relacionet e përgatitura nga MTI duhet të hartohen në Microsoft Word dhe/ose në Excel, të jenë të konvertueshme në Acrobat dhe të dorëzohen në formë dokumenti dhe në formë elektronike.

3.03 Konfidencialiteti

Përveç rasteve kur është dhënë pëlqimi paraprak me shkrim i Bankës, MTI dhe Marrësi nuk duhet të zbulojnë apo të lejojnë që agjentët e tyre apo nënkontraktorët t'u zbulojnë palëve të treta, dhe as të përdorin për qëllimet e tyre, çfarëdoj informacioni në lidhje me Shërbimet, Projektin apo Bankën, duke përfshirë informacione në lidhje me Kontratën e Konsulencës. MTI dhe Marrësi mund të ofrojnë të dhëna dhe informacione të tilla, nëse kërkohet nga ligji apo rregullorja në fuqi, por vetëm ajo pjesë e informacionit, e cila me aq sa lejon ligji apo rregullorja respektive, kërkohet ligjërisht që të ofrohet. Nëse bëhet një kërkesë e tillë, MTI dhe Marrësi duhet të informojnë menjëherë Bankën.

3.04 Drejtimi i operacioneve

Nëse Banka nuk ka mendim tjetër, atëherë MTI duhet të drejtojë biznesin dhe operacionet e saj (duke përfshirë edhe operacionet për çdo degë) në përputhje me standardet dhe praktikat administrative, teknike, financiare dhe mjedisore, të njohura ndërkomtarisht, nën mbikëqyrjen e një menaxhimi të kualifikuar dhe me eksperiencë, të asistuar nga një staf kompetent dhe të mjaftueshëm.

3.05 Mbështetja e Marrësit

Marrësi duhet:

i) të përmbushë siç duhet detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje;

ii) të mbështesë MTI-në të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë ndërmarrjen e të gjitha masave legjislative e rregulluese, apo të masave të tjera të nevojshme apo të dëshirueshme, si edhe duke përcaktuar apo duke mundësuar sigurimin e fondeve dhe mbështetjes për MTI, kur këto t'i nevojiten MTI për të realizuar Projektin; dhe

iii) të ndërmarrë çdo masë, në përputhje me ligjin shqiptar për ta vënë këtë Marrëveshje në zbatim.

Neni 4 Përfaqësimi

4.01 Përfaqësuesi i Autorizuar

Çdo masë e kërkuar apo e lejuar për t'u ndërmarrë, si edhe çdo akt i kërkuar apo i lejuar që të zbatohet, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të ndërmerret ose do të zbatohet:

a) në emër të marrësit nga z. Shkëlqim Cani apo nga një përfaqësues i emëruar; dhe

b) në emër të MTI nga z. Edmond Haxhinasto apo nga një përfaqësues i emëruar; dhe

c) në emër të Bankës nga drejtori, bashkëpunimi teknik apo nga cilido përfaqësues i autorizuar i Bankës.

4.02 Njoftime ose kërkesa

Çdo njoftim, kërkesë apo miratim i kërkuar apo i lejuar për t'u dhënë apo bërë, në përputhje me këtë Marrëveshje, duhet të hartohet me shkrim në gjuhën angleze. Çdo njoftim, kërkesë apo miratim do të konsiderohet si i dhënë apo i bërë kur dorëzohet personalisht te përfaqësuesi i autorizuar i palës së cilës i adresohet komunikimi, ose kur dërgohet me postë të regjistruar apo me faks palës në adresën e mëposhtme:

Për Marrësin

Për: z. Shkëlqim Cani

Ministër i Financave

Adresa: Ministria e Financave

Blv. "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë

Shqipëri

Telefon: + 355 4 2234 64

Faks: + 355 4 222 8494



Për MTI:

Për: z. Edmond Haxhinasto

Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Sheshi Skënderbej, nr. 5

Tirana

Shqipëri

Telefon: + 355 4 2234647

Për Bankën:

Për: Raphael Rashid

“Drejtuuesi i Operacionit”

Adresa: European Bank for Reconstruction
and Development

One Exchange Square London EC2A 2 JN,
Mbretëria e Bashkuar

Telefon: +44 20 7338 6581

Email: rashidr@ebrd.com

a) Njoftimi do të konsiderohet në fuqi për sa më poshtë:

i) në rast të dorëzimit personalisht apo më anë të postës së regjistruar për shpërndarjen; dhe

ii) në rast të fakseve të cilat ndjekin transmetimin e konfirmuar.

b) Një palë mund ta ndryshojë adresën për dorëzimin e njoftimeve apo kërkesave, duke njoftuar palën tjetër në përputhje me këtë klauzolë.

Neni 5

Pezullimi dhe ndërprerja

5.01 Njoftim i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës

MTI duhet të njoftojë menjëherë Bankën për pezullimin apo ndërprerjen e Kontratës së Konsulencës, apo për çdo zhvillim i cili mund të çojë në pezullimin apo ndërprerjen e Kontratës së Konsulencës.

5.02 Pezullimi i pagesave

Nëse ndodh një nga zhvillimet e mëposhtme dhe ky i fundit ndodh që të jetë në vazhdimësi, Banka, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Marrësit, pezullon menjëherë pagesën për Konsulentin pjesërisht ose plotësisht, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje:

a) nëse pezullohet Kontrata e Konsulencës, ose nëse Kontrata e Konsulencës ndërpritet, në përputhje me kushtet e Kontratës së Konsulencës;

b) nëse MTI nuk ka paguar taksat indirekte (duke përfshirë edhe TVSH-në) për faturat e

Konsulentëve për Konsulentin në kohën e duhur, në përputhje me kushtet e Kontratës së Konsulencës;

c) Nëse ka pasur ndonjë rrethanë tjetër, e cila sipas opinionit të arsyeshëm të Bankës, ndërhyt ose kërcënon të ndërhyjë në mbarëvajtjen e suksesshme të shërbimeve apo të Projektit, ose në përmbushjen e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.

5.03 Ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje nga Banka

a) Me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Marrësit, Banka mund ta ndërpresë këtë Marrëveshjeje nëse:

i) Ndonjë nga kushtet e përmendura në klauzolën 5.02 vazhdon për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh, pasi banka ka pezulluar plotësisht apo pjesërisht pagesat për Konsulentin dhe ka njoftuar me shkrim Marrësin; ose

ii) kontratës së Konsulencës i ka mbaruar afati ose është ndërprerë në përputhje me kushtet; ose

iii) marrësi dhe Banka bien dakord ta ndërpresin atë në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje; ose

iv) dhuruesi pezullon financimin e Grantit; ose

v) prokurimi i ndonjërit prej shërbimeve është i papajtueshëm me këtë Marrëveshjeje; ose

vi) fondet e paguara sipas kësaj Marrëveshjeje janë përdorur për qëllime të tjera nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshjeje;

b) Për çdo zhvillim, Banka mund ta ndërpresë këtë Marrëveshjeje në çdo moment, duke njoftuar fillimisht me shkrim Marrësin në një periudhë kohore jo më pak se dyzet ditë.

5.04 Procedura e ndërprerjes

Me ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje, sipas klauzolës 5.03, MTI do të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të reduktuar humbjet dhe për t'i mbajtur në minimum shpenzimet e tjera, sipas Kontratës së Konsulencës.

Neni 6

Të përgjithshme

6.01 Përjashtimi i detyrimeve

Pavarësisht çdo dispozite tjetër në këtë Marrëveshjeje, Banka nuk është përgjegjëse ndaj Marrësit, MTI apo Konsulentit sipas apo në lidhje me këtë Marrëveshjeje apo Kontratës së Konsulencës, për humbjet apo dëmet, edhe pse ato



janë shkaktuar ose nuk janë shkaktuar nga neglizhenca apo pakujdesia e Bankës. Kjo dispozitë nuk është e zbatueshme në rastin kur neglizhenca apo pakujdesia e Bankës shkakton vdekjen apo dëmtimin personal të MTI, apo të personelit të Konsulentit apo të ekspertëve.

6.02 Zhdëmtimi

MTI zhdëmton, dhe sipas privilegjeve dhe imuniteteve të Bankës, mbron Bankën, drejtorët, oficerët, punonjësit, agjentët dhe kontraktuesit e saj ndaj të gjitha kërkesave, dëmeve, kostove, shpenzimeve, detyrimeve, masave, humbjeve, të cilat lindin nga, kanë lidhje ose jo me çfarëdo veprimi ose pakujdesie nga ana e MTI apo Konsulentit, punonjësve, nënkontraktorëve apo agjentëve të tyre, edhe nëse ai mund të jetë i tërthortë, neglizhent apo i ndonjë forme tjetër, ose ndonjë shkelje prej tyre ndaj detyrimeve që ata kanë sipas kësaj Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës; apo çdo pamundësie nga ana e tyre për t'iu përmbajtur akteve, rregullave apo normave.

6.03 Praktikë e ndaluar

Banka, pa ndonjë paragjykim për çdo kompensim për shkelje të Marrëveshjes, mund ta ndërpresë menjëherë këtë Marrëveshje nëse Marrësi, dhe/ose MTI, sipas gjykimit të Bankës, janë përfshirë në praktika të ndaluara gjatë konkurrencës për Kontratën e Konsulencës apo gjatë zbatimit të saj.

“Praktikë e korruptuar” do të thotë të ofrosh, të japësh, të marrësh, apo të kërkosh në mënyrë direkte apo indirekte çdo gjë me një vlerë të tillë që mund të ndikojë në mënyrën e gabuar në veprimet e një pale tjetër në lidhje me procesin e përzgjedhjes, apo në zbatimin e Kontratës në mënyrë që të sigurojë apo ruajë biznesin apo ndonjë avantazh tjetër të papërshtatshëm në administrimin e biznesit.

“Praktikë mashtruese” do të thotë çdo veprim apo pakujdesi, duke përfshirë edhe një keqpërfaqësim, i cili me qëllim apo për pakujdesi mund të mashtrtojë një palë që kjo e fundit të sigurojë një përfitim financiar apo një përfitim të një natyre tjetër apo të shmang një detyrim.

“Praktikë detyruese” do të thotë të përkeqësosh apo të dëmtosh, apo të kërcënosh të përkeqësosh ose të dëmtosh në mënyrë direkte ose indirekte, cilëndo palë apo pronë të palës, për të ndikuar negativisht në veprimet e palës për sa ka të bëjë me

procesin përzgjedhës apo me zbatimin e Kontratës në mënyrë që të përvetësosh apo të ruash biznesin apo ndonjë avantazh tjetër të papërshtatshëm gjatë administrimit të biznesit.

“Praktikë e fshehtë dhe mashtruese” do të thotë një marrëveshje midis dy ose më shumë palëve me qëllimin për të përmbushur një objektiv të gabuar, duke përfshirë edhe ndikimin e keq në veprimet e një pale tjetër, dhe përfshin çdo marrëveshje midis konsulentëve (përpara apo pas dorëzimit të propozimeve), me synimin për të përcaktuar çmime në nivele artificiale jokonkurrenuese dhe për të privuar MTI nga përfitimet e konkurrencës së lirë dhe të hapur.

6.04 Inspektimi dhe auditimi nga Banka

MTI duhet të lejojë Bankën ose përfaqësuesin e saj të autorizuar të inspektojë llogaritë dhe të dhënat e saj në lidhje me përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës dhe Shërbimeve si edhe të lejojë auditimin e këtyre llogarive nga auditet e caktuar nga Banka, nëse një gjë e tillë kërkohet nga Banka.

6.05 Sigurimet

Të pazbatueshme

6.06 Ligji drejtues dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Kjo Marrëveshje interpretohet në përputhje me ligjin anglez. Çdo detyrim jokontraktual i cili paraqitet jashtë apo në përputhje me këtë Marrëveshje administrohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin anglez.

b) Çdo mosmarrëveshje apo pretendim i cili lind nga kjo Marrëveshje apo në lidhje me të, apo nga shkelja, ndërprerja apo shfuqizimi, apo çdo detyrim jokontraktual që lind nga kjo Marrëveshje apo në lidhje me të, i cili nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore, zgjidhet me anë të arbitrazhit në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të UNCITRAL (Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Ligjet Tregtare Ndërkombëtare-KKBLTN), të cilat janë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje. Duhet të jetë: 1) një arbitër, ndërsa autoriteti emëruar për qëllimet e Rregullave të UNCITRAL (KKBLTN) duhet të jetë Gjykata Londineze e Arbitrazhit Ndërkombëtar (GJLAN). Vendi i arbitrazhit duhet të jetë Londra, Angli dhe gjuha angleze duhet të përdoret gjatë gjithë procedurave arbitrarë. Palët heqin dorë nga çdo e drejtë sipas Aktit të Arbitrazhit, i vitit 1996, ose në të kundërt



ato duhet të apelojnë për arbitrazh apo të kërkojnë përcaktimin e një ligji paraprak nga gjykatat e Anglisë apo diku tjetër. Arbitri nuk është i autorizuar të ndërmarrë masa të përkohshme ndaj Bankës, pavarësisht dispozitave të Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL (KKBLTN), dhe MTI duhet të bjerë dakord se nuk do t'i kërkojë ato nga asnjë autoritet gjyqësor.

c) Asnjë element në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet si dorëheqje, tërheqje apo modifikim nga ana e Bankës në lidhje me imunitetet, privilegjet apo përjashtimet e Bankës sipas Marrëveshjes për Ndërtimin e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, sipas konventës ndërkombëtare apo çdo ligji të zbatueshëm. Pavarësisht nga sa më sipër, Banka ka bërë një kërkesë të posaçme për arbitrazh sipas seksionit 6.06 (b) të kësaj Marrëveshjeje, dhe në përputhje dhe pa paramenduar për privilegjet dhe imunitetet e saj (duke përfshirë, pa limit paprekshmërinë e arkivave të saj), ajo pranon se nuk ka imunitet ndaj procesit gjyqësor, sipas nenit 5 (2) të Instrumentit të Statutit 1991, nr. 757 (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (imunitetet dhe privilegjet) urdhri 1991), apo ndonjë dispozite tjetër sipas ligjeve angleze, në lidhje me zbatimin e një vendimi arbitrazhi kundër saj, si rezultat i kërkesës së saj të posaçme për arbitrazh në zbatim të seksionit 6.06(b) të kësaj Marrëveshjeje.

6.07 Efikasiteti

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi sapo të përfundojnë procedurat e brendshme për hyrjen e saj në fuqi, në përputhje me ligjin shqiptar, dhe nëse nuk pezullohet apo ndërpritet në përputhje me nenin V, dhe mbetet në fuqi derisa të plotësohen Shërbimet dhe të gjitha pagesat sipas Kontratës së Konsulencës.

6.08 Amendimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të amendohet vetëm me mirëkuptimin me shkrim midis Bankës dhe Marrësit, i zbatuar sipas rregullave nga përfaqësuesit e autorizuar.

6.09 E gjithë Marrëveshja

Kjo Marrëveshje, së bashku me të gjitha shtojcat bashkëngjitur, e amenduar herë pas here në përputhje me klauzolën 6.08, përmban të gjithë arsyetimin dhe marrëveshjen midis palëve dhe pezullon të gjitha propozimet apo marrëveshjet e tjera në lidhje me subjektin e kësaj Marrëveshjeje.

Faqe | 1906

Asnjë palë nuk mbështetet në sipërmarrjen apo përfaqësimin nga ndonjë palë tjetër, e cila nuk është pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

6.10 Pasuesit

Kjo Marrëveshje lidhet dhe hyn në zbatim për përfitimet e pasuesve respektivë dhe të personave të cilëve u janë kaluar të drejtat e palëve.

6.11 Përjashtimi i të drejtave të palëve të treta

Kjo Marrëveshje nuk krijon ndonjë të drejtë sipas aktit të kontratave (të drejtat e palëve të treta) 1999, e zbatueshme nga persona apo entitete të cilat nuk janë palë me të, me përjashtim të rastit kur një entitet apo person, i cili është pasues ose të cilit i janë kaluar të drejtat e një pale, mendohet të jetë palë me këtë Marrëveshjeje.

6.12 Klauzolat që mbeten në fuqi

Klauzolat 3.03, 6.01, 6.02, 6.03, 6.04 dhe 6.06 do t'i mbijetojnë ndërprerjes apo mbarimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje.

6.13 Gjuha

Anglishtja është gjuha e Marrëveshjes. I gjithë komunikimi, dokumentacioni dhe raportet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratës së Konsulencës duhet të përgatiten dhe prezantohen në gjuhën angleze. Gjatë çdo mosmarrëveshjeje në lidhje me gjuhën, mbizotëron versioni i anglishtes.

6.14 Garanci të tjera

Herë pas here, me kërkesën e Bankës, MTI duhet të angazhohet vetë, ose të angazhojë Konsulentin, të përmbushë dhe të shpërndajë dokumente të tjera, si edhe të bëjë këto akte të tjera në përputhje me kërkesat e arsyeshme të Bankës, në mënyrë që të tregojë, drejtojë dhe t'i japë efekt të plotë ligjor kushteve, qëllimit dhe domethënies së kësaj Marrëveshjeje.

6.15 Respektimi i afateve

E pazbatueshme

6.16 Kopjet origjinale të Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të përgatitet në tri kopje, secila duhet t'i përmbahet një dhe së njëjtës Marrëveshjeje.

6.17 Logoja e BERZH-it

MTI dhe Marrësi informohen se logoja e Bankës është një simbol i regjistruar shërbimi; dhe as MTI dhe as Marrësi nuk mund ta riprodhojnë një logo të tillë pa lejen e posaçme me shkrim të Bankës.

Në prani të dëshmitarëve, palët, me anë të përfaqësuesve të tyre të autorizuar kanë firmosur



këtë Marrëveshje në tri kopje, në gjuhën angleze, në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

PËR DHE NË EMËR TË MARRËSIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,
përfaqësuar nga Ministri i Financave

Shkëlqim Cani

Ministër i Financave

Ministria e Financave

Data:

**PËR DHE NË EMËR TË BANKËS
EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM**

Stephen Gillard

Kryekëshilltar

Bashkëpunim Teknik

Datë:

SHTOJCA A

**FORMULARI I DEKLARATËS PËR
MIRATIMIN E SHËRBIMEVE TË
KONSULENCËS**

Të firmoset nga Ministria e Transportit dhe
Infrastrukturës dhe të dërgohet nga Konsulenti me
faturat për Shërbimet.

Fatura nr.

Data e faturës:

Shuma e faturës:

Marrëveshja e Grantit nr.: C28906/EBSF-2011-
12-179 OL: Marcial Bustinduy Navas

1. Në vijim të Kontratës së Konsulencës për
Shqipërinë: Plani i Qëndrueshëm i Transportit
ë“Shërbimet”), më datë _____,
ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe
Infrastrukturës [“MTI”] dhe [“Konsulenti”];
dhe në vijim të klauzolës 2.02 “d” të Marrëveshjes
së Grantit për Shërbimet, më datë xxxxxx, midis
Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
[“Banka”] dhe Marrësit, MTI pohon se:

i) MTI ka marrë dhe është e kënaqur me
shërbimet e konsulentit, për të cilat është
kontraktuar në Kontratën e Konsulencës, shërbime
të cilat mbulohen nga faturat bashkëlidhur;

ii) MTI ka kontrolluar faturat dhe të gjitha
dokumentet mbështetëse, të cilat kanë lidhje me
përmbushjen e shërbimeve kundrejt shumave të

përcaktuara në Kontratën e Konsulencës dhe
siguron se:

a) fatura/faturat është/janë një pasqyrim i
vërtetë i Shërbimeve të ofruara nga Konsulenti; dhe

b) shuma/shumat e/të tarifuar/a në faturë/a
korrespondon/dojnë me shumën/shumat e
përcaktuar/a në Kontratën e Konsulencës;

iii) fatura/t dhe të gjitha dokumentet
mbështetëse janë dërguar së bashku me këtë
deklaratë për miratim adresuar skuadrës së
faturimit KS, Njësia e Kontrollit të Faturave të
Bankës për pagesën; dhe

iv) MTI ka paguar çdo taksë indirekte duke
përfshirë TVSH-në për Konsulentin sipas faturave
të mëparshme dhe merr përsipër të paguajë faturat
indirekte duke përfshirë TVSH-në në lidhje me
faturën/faturat bashkëlidhur brenda 30 ditëve nga
data e kësaj deklarate miratimi.

2. MTI pohon se duke nënshkruar këtë
dokument, MTI autorizon Bankën të bëjë pagesën
e Konsulentit, për të cilën është rënë dakord në
Kontratën e Konsulencës, në emër të MTI.

Në prani të dëshmitarëve, pala, me anë të
përfaqësuesit të saj të autorizuar ka nënshkruar këtë
kontratë, më [data].

Për dhe në emër të

Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës

VENDIM

Nr. 246, datë 19.3.2015

**PËR NGARKIMIN E GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
KRYERJEN E PROCEDURËS SË
PROKURIMIT PËR MARRJEN ME QIRA
FINANCIARE TË AUTOMJETEVE NË
DISPOZICION TË DISA
FUNKSIONARËVE PUBLIKË DHE
KRYEMINISTRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të
nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për
prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit
nr.9396, datë 12.5.2005, “Për qiranë financiare”,
dhe të neneve 2, pika 1, e 6, të ligjit nr.10160,
datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të
transportit për funksionarët publikë dhe
nëpunësit civilë”, me propozimin e ministrit të
Financave, ministrit të Punëve të Brendshme dhe



ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës,
Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Gardës së Republikës së Shqipërisë, si organi qendror blerës, për kryerjen e procedurës së prokurimit, në emër dhe për llogari të autoriteteve kontraktore, të përcaktuara në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për marrjen me qira financiare të automjeteve në dispozicion të përhershëm të Kryeministrit dhe të disa funksionarëve publikë, personalitete të larta shtetërore dhe të shtetit, sipas ligjit nr.8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Garda e Republikës së Shqipërisë, si organi qendror blerës, të prokurojë fondin limit, të llogaritur si shumë e fondeve buxhetore, të miratuar për çdo institucion të përmendur në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, brenda datës 31 mars 2015, të dërgojnë në Gardën e Republikës së Shqipërisë,

si organi qendror blerës, fondin përkatës, sipas numrit dhe tipologjisë së automjeteve të përcaktuara në lidhjen nr.1.

4. Garda e Republikës së Shqipërisë, si organi qendror blerës, së bashku me përfaqësues, në nivel teknik, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, të përcaktojnë specifikimet teknike, në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat e sigurisë për automjetet që do të merren me qira financiare.

5. Garda e Republikës së Shqipërisë, si organi qendror blerës, është plotësisht përgjegjëse për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit deri në përzgjedhjen e fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti kontraktor.

6. Ngarkohen Garda e Republikës së Shqipërisë dhe institucionet e përmendura në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Lidhja nr.1

LISTA

**E INSTITUCIONEVE QË DO TË MARRIN ME QIRA FINANCIARE AUTOMJETE
NË DISPOZICION**

Nr.	Institucioni (autoritet kontraktor)	Automjet në dispozicion të funksionarit publik	Automjet në dispozicion të aparatit të institucionit
1	Presidenca	2	-
2	Kuvendi	4	-
3	Kryeministria	8	14
4	Ministria e Punëve të Jashtme	1	--
5	Ministria e Mbrojtjes	1	-
6	Ministria e Punëve të Brendshme	1	-
7	Ministria e Integritimit Evropian	1	-
8	Ministria e Financave	1	-
9	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	1	-
10	Ministria e Zhvillimit Urban	1	-
11	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	1	-
12	Ministria e Arsimit dhe Sportit	1	-
13	Ministria e Drejtësisë	1	-
14	Ministria e Kulturës	1	-
15	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	1	-
16	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	1	-
17	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave	1	-
18	Ministria e Shëndetësisë	1	-
19	Ministria e Mjedisit	1	-
	Gjithsej	29	14

**VENDIM**

Nr. 248, datë 18.3.2015

**PËR NGRITJEN E KOMITETIT
SHTETËROR, PËR BASHKËRENDIMIN
E PUNËS, PËR ORGANIZIMIN E
AKTIVITETEVE NË KUADËR TË
NISMËS “LUTJA E PAQES 2015”, NË
BASHKËPUNIM ME KOMUNITETIN
SANT’EGIDIO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant’Egidio-s, për selinë dhe veprimtarinë e këtij Komuniteti në Shqipëri, të ratifikuar me ligjin nr.9628, datë 30.10.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant’Egidio-s për selinë dhe veprimtarinë e këtij Komuniteti në Shqipëri”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Komitetit Shtetëror, për bashkërendimin e punës, për organizimin e aktiviteteve, në kuadër të nismës “Lutja e Paqes 2015”, që do të organizohen në datat 6-8 shtator 2015.

2. Komiteti Shtetëror të kryesohet nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- a) Nga institucionet shtetërore:
- përfaqësues nga kabineti i Kryeministrit;
 - ministri i Punëve të Brendshme;
 - ministri i Mbrojtjes;
 - ministri i Financave;
 - ministri i Kulturës;
 - ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
 - ministri i Arsimit dhe Sportit;
 - ministri i Zhvillimit Urban;
 - drejtori i Protokollit të Shtetit;
 - komandanti i Gardës së Republikës së Shqipërisë.

b) Me pëlqimin paraprak të tyre, nga një përfaqësues të:

- kabinetit të Presidentit;

- Kryetarit të Kuvendit;
- Bashkisë Tiranë;
- Komitetit të Kulteve;
- Komunitetit të Sant’Egidio-s;
- Komunitetit Katolik, në Shqipëri;
- Komunitetit Ortodoks, në Shqipëri.

3. Komiteti Shtetëror, në kuadër të aktiviteteve që do të organizohen për nismën “Lutja e Paqes 2015”, në datat 6-8 shtator 2015, të angazhohet dhe të marrë përsipër këto përgjegjësi:

a) Bashkërendimin e punës për organizimin e aktiviteteve, në kuadër të nismës “Lutja e Paqes 2015”;

b) Përcaktimin e detyrave për institucionet e tyre dhe të varësisë;

c) Bashkërendimin e punës për aktivizimin e fondeve, koordinimin e aspekteve financiare dhe përgatitjen e aktit përkatës për përballimin e shpenzimeve për realizimin e veprimtarive, të parashikuara në kalendarin e aktiviteteve për këtë nismë.

4. Komiteti Shtetëror mblidhet me kërkesën e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në cilësinë e kryetarit të këtij Komiteti.

5. Në mbledhjen e parë të Komitetit Shtetëror zgjidhet sekretariati teknik i këtij Komiteti, i cili ka këto detyra:

a) Organizon takimet e Komitetit Shtetëror;

b) Raporton, periodikisht, pranë këtij Komiteti, për realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet e mëparëshme të tij;

c) Bashkërendon punën ndërmjet institucioneve të përfshira për zbatimin dhe monitorimin e detyrave të lëna prej Komitetit;

ç) Mban procesverbalet dhe harton vendimet e marra nga Komiteti;

d) Kryen detyra të tjera, që përcaktohen nga kryetari i Komitetit.

6. Përbërja, mënyra e funksionimit dhe detyrat e hollësishme të sekretariatit teknik përcaktohen me vendim të Komitetit Shtetëror.

7. Kryetari i Komitetit i raporton, periodikisht, Këshillit të Ministrave për ecurinë e punës së këtij Komiteti.

8. Ngarkohen të gjithë përfaqësuesit e institucioneve, anëtarë të Komitetit, për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 250, datë 18.3.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR.850, DATË 15.12.2006, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
TRANSFERIMIN, NË PRONËSI, DISA
BASHKIVE, TË PRONAVE QË JANË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR”, DHE
PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.60,
DATË 1.2.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI SHËRBIMIT SOCIAL
SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8/a, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr.160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.850, datë 15.12.2006, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Revokohet e drejta e pronësisë së Bashkisë Shkodër për objektin e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1.

2. Shkronja “a”, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Objekti me numër rendor 11 në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra e shërbimeve për të moshuarit”, Shkodër, të kalojë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.”.

3. Prona e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr.60, datë 1.2.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR
Nr. 57, datë 2.3.2015

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa "a", të vendimit nr. 997, datë 10.2.2010 të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave Drejtorit të Përgjithshëm të Punësimit, Arsimit dhe Formimit Profesional, znj. Silva Banushi për dërgimin me shërbim të punonjësve të shkollave të arsimit profesional, jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, Drejtori i Përgjithshëm i Punësimit, Arsimit dhe Formimit Profesional të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar.

3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Punësimit, Arsimit dhe Formimit Profesional për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri, deri më 31.12.2015.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj



URDHËR
Nr. 87, datë 16.1.2015

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 27 dhe 29 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të shkronjës "a", të pikës 1, të kreut V, të vendimit nr. 1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, zëvendësministrit të Mbrojtjes, z. Petro Koçi, për procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël.

2. Ngarkohen zëvendësministrat e Mbrojtjes dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri.

3. Urdhri nr. 359, datë 28.3.2014 i ministrit të Mbrojtjes “Për delegim kompetencash” të titullarit të autoritetit kontraktor zëvendësministrit të Mbrojtjes, z. Dritan Hila, revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MBROJTJES
Mimi Kodheli

URDHËR
Nr. 461, datë 16.3.2015

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 27 dhe 29 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zëvendësministrit të Mbrojtjes z. Petro Koçi, i delegohet kompetenca për nënshkrimin e autorizimeve për përfaqësimin e Ministrisë së Mbrojtjes në proceset gjyqësore, të padive të ngritura nga Ministria e Mbrojtjes, të ankimeve

në Gjykatën e Apelit dhe rekurseve në Gjykatën e Lartë, ku palë e paditur/paditëse është Ministria e Mbrojtjes.

2. Autorizimet e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij urdhri do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

3. Ndjek dhe ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri zëvendësministri i Mbrojtjes, sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Drejtoria Juridike.

4. Urdhri nr. 1909, datë 17.10.2013 i ministrit të Mbrojtjes, “Për delegim kompetence”, revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MBROJTJES
Mimi Kodheli

URDHËR
Nr. 462, datë 16.3.2015

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR
DHËNIEN E NDIHMAVE FINANCIARE
PËR USHTARAKËT E FORCAVE TË
ARMATOSURA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 27 dhe 29 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për dhënie e ndihmës financiare të menjëhershme, sipas nenit 30, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose fatkeqësie natyrore, tek zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri.



3. Urdhri nr. 360, datë 28.3.2014 i ministrit të Mbrojtjes “Për delegim kompetencash për dhënie e ndihmave financiare për ushtarakët e Forcave të Armatosura”, revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MBROJTJES
Mimi Kodheli

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2015-712- (356), datë 20.2.2015, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Ilia Shkira, duke përcaktuar si datë të vdekjes së tij datën 1.1.1991.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë